

Bilanci i energjisë elektrike

Viti 2024


Tiranë, më 3 Mars 2025: Gjatë vitit 2024, energjia elektrike në dispozicion u rrit me 3,7 %.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike, në vitin 2024, arriti vlerën 7.837 GWh nga 8.796 GWh energji të prodhuar në vitin 2023, duke shënuar një rënie të prodhimit me 10,9 %.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 52,1 %, nga hidrocentralet private dhe koncensionare në masën 41,4 % dhe nga të tjerë prodhues në masën 6,5 % të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje) arriti vlerën 2.669 GWh nga 1.922 GWh që ishte një vit më parë, duke shënuar kështu një rritje me 38,9 %. **Eksporti bruto** i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti vlerën 2.335 GWh nga 2.842 GWh duke shënuar një rënie me 17,8 % (tab.1).

Fig. 1 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto



Për publikim 03/03/2025

Tab. 1 Bilanci i energjisë elektrike, 2023-2024

MWh

Treguesit	2023	2024
A Energji në dispozicion (A=1+2-3)	7.875.822	8.170.517
1 Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	8.795.634	7.836.625
1.1 Termocentrale	0	0
1.2 Hidrocentrale (1.2=a+b)	8.705.910	7.330.077
a Publike (a=a.1-a.2)	5.123.417	4.084.914
a.1 Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	5.166.787	4.124.239
a.2 Humbje dhe konsum vetjak	43.370	39.325
b Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	3.582.493	3.245.163
1.3 Të tjerë prodhues ¹	89.724	506.548
2 Importi bruto (energji në marrje)	1.921.743	2.668.771
3 Eksporti bruto (energji në dhënie)	2.841.555	2.334.878
B Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	7.875.822	8.170.517
1 Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	1.654.540	1.614.264
1.1 Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	220.267	201.342
1.2 Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ²	1.434.273	1.412.922
a Humbjet teknike në shpërndarje	990.500	997.284
b Humbjet jo teknike në shpërndarje ³	443.773	415.638
2 Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	6.221.282	6.556.253
2.1 Familjarë	3.116.817	3.408.870
2.2 Jo Familjarë	3.104.465	3.147.383

¹Të tjerë prodhues i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshiruar energjinë hidro dhe termo (fotovoltaikë, naftë, etj.)

²Detajimi i humbjeve teknike dhe jo-teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

³Humbjet jo- teknike përbëjnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.


Hidrocentralet publike, në vitin 2024, prodhuan 4.085 GWh nga 5.123 GWh të prodhuar në vitin 2023, duke shënuar kështu një rënie të prodhimit me 20,3 %.

Hidrocentralet private dhe koncensionare, prodhuan 3.245 GWh nga 3.582 GWh të prodhuar një vit më parë, duke shënuar një rënie të prodhimit të energjisë elektrike me 9,4 %.

Të tjerë prodhues, prodhuan 507 GWh nga 90 GWh të prodhuar në vitin 2023, duke shënuar një rritje të prodhimit të energjisë elektrike me 5,6 herë.

Shkëmbimi i energjisë elektrike (diferenca mes eksportit dhe importit bruto të energjisë), në vitin 2024, ka arritur vlerën negative prej 334 GWh (fig.2).


Fig. 2 Shkëmbimi i energjisë elektrike



Humbjet në rrjet kanë arritur vlerën 1.614 GWh në vitin 2024 nga 1.655 GWh në vitin 2023, duke shënuar një rënie me 2,4 %. Pesha që zënë **humbjet në rrjet** në totalin e energjisë elektrike në dispozicion gjatë vitit 2024 është 19,8 % nga 21,0 % që ishte në vitin 2023, duke shënuar një ulje me 1,2 %.

Gjatë vitit 2024, **humbjet në transmetim** janë ulur me 8,6 % dhe **humbjet në shpërndarje** janë ulur me 1,5 %, krahasuar me vitin 2023 (fig.3).


Fig. 3 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët



Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në vitin 2024, arriti vlerën 6.556 GWh nga 6.221 GWh që ishte në vitin 2023.


Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë u rrit me 9,4 %, duke arritur vlerën 3.409 GWh në vitin 2024 nga 3.117 GWh që ishte në vitin 2023, ndërsa **përdorimi nga konsumatorët jo familjarë** u rrit me 1,4 % duke arritur vlerën 3.147 GWh në vitin 2024, nga 3.104 GWh që ishte një vit më parë (fig.4).

Fig. 4 Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët



Në fig.5 paraqitet **struktura në përqindje e prodhimit neto vendas sipas tremujorëve** për periudhën 2020-2024. Në vitin 2024 kemi një rënie të prodhimit neto vendas në tremujorin e parë dhe të dytë dhe një rritje të prodhimit neto vendas në tremujorin e tretë dhe të katërt, krahasuar me vitin 2023.

Fig. 5 Struktura në përqindje e prodhimit neto vendas sipas tremujorëve, 2020 - 2024 (%)



Tremujori IV 2024

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, **energjia elektrike në dispozicion** u rrit me 6,6 %. **Prodhimi neto vendas** i energjisë elektrike, në tremujorin e katërt të vitit 2024, arriti vlerën 1.953 GWh, nga 2.129 GWh energji të prodhuar në tremujorin e katërt të vitit 2023, duke shënuar një rënie të prodhimit me 8,2 % (tab.2).

Tab. 2 Bilanci i energjisë elektrike, tremujori IV

MWh

Treguesit	Tr. IV 2023	Tr. IV 2024
A Energji në dispozicion (A=1+2-3)	1.995.514	2.128.077
1 Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	2.128.517	1.953.147
1.1 Termocentrale	0	0
1.2 Hidrocentrale (1.2=a+b)	2.110.987	1.826.386
a Publike (a=a.1-a.2)	1.087.011	1.014.176
a.1 Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	1.097.158	1.024.108
a.2 Humbje dhe konsum vetjak	10.147	9.932
b Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	1.023.976	812.210
1.3 Të tjerë prodhues ¹	17.530	126.760
2 Importi bruto (energji në marrje)	565.508	748.626
3 Eksporti bruto (energji në dhënie)	698.511	573.695
B Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	1.995.514	2.128.077
1 Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	434.507	464.491
1.1 Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	55.596	51.727
1.2 Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ²	378.911	412.764
a Humbjet teknike në shpërndarje	258.539	263.978
b Humbjet jo teknike në shpërndarje ³	120.372	148.786
2 Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	1.561.007	1.663.586
2.1 Familjarë	796.658	881.729
2.2 Jo Familjarë	764.349	781.857


¹Të tjerë prodhues i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshiruar energjinë hidro dhe termo (fotovoltaikë, naftë, etj.)

²Detajimi i humbjeve teknike dhe jo-teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

³Humbjet jo-teknike pëmbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.


Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, **importet bruto** të energjisë elektrike (energji në marrje) u rritën me 32,4 % dhe **eksportet bruto** të energjisë elektrike (energji në dhënie) u ulën me 17,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (fig.6).

Fig. 6 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto



Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët u rrit me 6,6 %. **Përdorimi nga konsumatorët familjarë** u rrit me 10,7 %, **përdorimi nga konsumatorët jo familjarë** u rrit me 2,3 % (fig.7).

Fig. 7 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët



Metodologjia

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për një periudhë tremujore nga të dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative si:

- KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSSH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
 - furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
 - transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
 - tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Përkufizimet e treguesve bazë

Energji në dispozicion i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).

Prodhimi neto vendas llogaritet si shumë e sasisë bruto të energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

Energji termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

Energji hidro i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentralet.

Humbjet dhe konsumi vetjak i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me prodhimin si psh. ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.

Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike të cilët në rastin e Shqipërisë përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe liqenohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSSH-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientë të tjerë.

Prodhues të tjerë i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshiruar energjinë hidro dhe termo.

Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet (dhënie – marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.

Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.

Humbjet në rrjet përbëjnë humbjet në transmetim duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim si edhe humbjet në shpërndarje. *Humbjet teknike* në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSSH sh.a. *Humbjet jo teknike* i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje si edhe të diferencave statistikore që rrjedhin nga ndryshimet në kohën e matjes së prodhimit, e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë.

Familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.

Në llogaritjen e këtij treguesi përfshihet edhe *dëmi ekonomik* i llogaritur për konsumatorët familjarë.

Jo familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj. duke përfshiruar konsumin nga familjarët.

Në llogaritjen e këtij treguesi përfshihet edhe *dëmi ekonomik* i llogaritur për konsumatorët jo familjarë.